




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.519/2023
Datë: 27 nëntor 2023

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr.01/2023 Për Procedurën për Kompensimin e Dëmit të Personave të Dënuar ose të Arrestuar pa Arsye, në takimin 317-të, të mbajtur me datë 27 nëntor 2023, merr këtë:

V E N D I M

- I. Z. Ragip Namani, gjyqtar Gjykatën Supreme të Kosovës, caktohet anëtar i Komisionit për kompensimin e dëmit për personat e dënuar ose arrestuar pa arsye.
- II. Mandati i z. Namani, fillon nga data 7 dhjetor 2023 dhe është tri (3) vite.
- III. Anëtari i komisionit kompensohet konform legjislacionit në fuqi.
- IV. Vendimi hyn në fuqi me datë 27 nëntor 2023.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me vendimin KGJK.nr.338/2021, të datës 15 nëntor 2021, ka caktuar anëtarët e Komisionit për kompensimin e dëmit për personat e dënuar ose arrestuar pa arsye, me mandat tre (3) vjeçar.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, ka njoftuar se z. Gëzim Lllolluni, gjyqtar në Gjykatën e Apelit, konform nenit 34 të Ligjit Nr. 06/L-054 për Gjykatat, me datë 6 dhjetor 2023, i përfundon mandati i gjyqtarit për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, me ç'rast i përfundon edhe mandati i anëtarit në Komisionin për kompensimin e dëmit për personat e dënuar ose arrestuar pa arsye.

Këshilli, pas shqyrtimit të kësaj çështje vendosi të caktoj z. Ragip Namani, gjyqtar në Gjykatën Supreme, anëtar të Komisionit për kompensimin e dëmit për personat e dënuar ose arrestuar pa arsye, mandati i të cilit fillon nga data 7 dhjetor 2023.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Z. Ragip Namani, gjyqtar në Gjykatën Supreme;
- Komisionit për kompensimin e dëmit për personat e dënuar ose arrestuar pa arsye;
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.